



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 2/952  
Datë: 27/11/2020

Senati i Universitetit të Prishtinës, bazuar në kompetencat e përcaktuara sipas nenit 48, paragrafit 1.22 dhe 1.23, të Statutit, me propozim të Këshillave të njëjësive akademike, në mbledhjen e datës 19.11.2020, miratoi këtë

**V E N D I M**

1. Lejohet plotësimi/kompensimi i orëve të humbura të ligjëratave dhe ushtrimeve për muajin tetor të vitit akademik 2020/21, për studentët e nivelit baçelor.
2. Plotësimi/kompensimi i orëve të humbura për studentët e nivelit baçelor, do të realizohen gjatë muajit nëntor dhe dhjetor të vitit 2020.
3. Lejohet plotësimi/kompensimi i orëve të humbura të ligjëratave dhe ushtrimeve për muajin tetor dhe nëntor të vitit akademik 2020/21, për studentët e nivelit master.
4. Plotësimi/kompensimi i orëve të humbura për studentët e nivelit master, do të realizohen gjatë muajit dhjetor të vitit 2020 dhe muajit janar të vitit 2021.
5. Këshillit Drejtues të UP-së, i rekomandohet që të nxjerrë vendim për lejimin e kompensimit financiar të orëve të plotësuara si në pikën 1-4 të këtij vendimi.
6. Vendimi do të zbatohet nga njësitë akademike të Universitetit të Prishtinës.
7. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit në Senat.

**Arsyetim**

Si pasojë e situatës së pandemisë COVID-19 dhe kufizimeve të kohëpaskohshme të aktiviteteve të përgjithshme në sistemin arsimor parauniversitar dhe universitar, është shtyrë edhe mbajtja e provimit të maturës, e cila detyrimisht e ka imponuar edhe shtyrjen e afatit për pranimin e studentëve të ri deh fillimin e procesit mësimor në dy nivelet e studimeve, respektivisht në nivelin baçelor dhe master. Meqenëse sipas planprogrameve mësimore është i përcaktuar fondi i orëve të ligjëratave dhe ushtrimeve për secilën lëndë mësimore, është e pashmangshme edhe nevoja për plotësimin/kompensimin tyre në mënyrë që të konsiderohet se studenti ka arritur të akumuloj njohuri të nevojshme për lëndën përkatëse, prandaj nisur nga argumentet e sipërshënuara me kërkesë të këshillave të njëjësive akademike dhe rektorit të UP-së, Senati vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'u dorëzohet:

1. Arkivit të UP-së;
2. Menaxhmentit të UP-së;
3. Këshillit Drejtues të UP-së;
4. Sekretarit të përgjithshëm të UP-së;
5. Dekanëve të njëjësive akademike të UP-së;
6. Sekretarëve të njëjësive akademike;
7. Zyrës për çështje akademike të UP-së, dhe
8. Për publikim në ueb-faqe.



Kryesues i Senatit

*Naser Sahiti*  
Prof. dr. Naser Sahiti, rektor